

**Terma reference**  
**Njoftim për punësim**

Pozicioni	Psikolog, psikoterapist, punonjës social, mësues, animator social, jurist
Projekti	Mbështetje për pranimin dhe integrimin vullnetar humanitar të shtetasve afganë në Shqipëri (EN: Support for the voluntary humanitarian admission and integration of Afghan Nationals in Albania)
Zonat e projektit	Lezhë dhe Tiranë
Kohëzgjatja e projektit	01 Gusht 2024 – 30 Prill 2026
Lloji i kontratës	Kontratë Pune Individuale me kohë të plotë
Data e fillimit të punës	02 Shtator 2024

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të punësojë **një ekip multidisiplinar (psikolog, psikoterapist, punonjës social, mësues, animator social dhe jurist)** që do të mundësojnë ofrimin e një paketë të plotë shërbimesh mbështetëse dhe riintegruese për familjet afgane të akomoduar në Shqipëri në kuadër të zbatimit të programit për integrimin e familjeve Afgane në Shqipëri në partneritet me IOM Shqipëri dhe financim të Byrosë së Popullsisë, Refugjatëve, dhe Migracionit (PRM) e Departamenti të Shtetit të SHBA.

### Rreth Nisma ARSIS

**Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS** (shkurtimisht Nisma ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. Nisma ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Nisma ARSIS është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Nisma ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabel.

### Rreth projektit

Projekti ka si qëllim të ofrojë një përgjigje gjithëpërfshirëse për nevojat e shtetasve afganë të zhvendosur së fundmi në Shqipëri. Metodologjia e programit fokusohet në ofrimin e një kuadri të integruar që synon të mbulojë të gjitha aspektet e mbështetjes së nevojshme për këtë grup përfituesish. Në qendër të kësaj qasjeje qëndron zbatimi i shërbimeve të personalizuara të menaxhimit të rasteve, duke u siguruar që çdo grup përfitues të marrë mbështetjen e duhur në bazë të nevojave të tyre specifike. Menaxherët e rasteve të caktuar për çdo familje do të luajnë një rol kyç si pika kryesore e kontaktit. Ata do të jenë përgjegjës për të lehtësuar aksesin në një gamë të gjerë shërbimesh dhe përfitimesh që janë dizajnuar për të përmbushur nevojat e veçanta të secilës familje.

Nisma ARSIS sjell një përvojë të pasur në zbatimin e programit, veçanërisht në fushat e menaxhimit të rasteve, rehabilitimit dhe riintegrit, mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik (MHPSS), dhe praktikave të sigurisë. Gjithashtu, bashkëpunimi i ngushtë me institucionet lokale dhe qendrore synon forcimin e ndërhyrjeve duke siguruar një koordinim më të mirë dhe një kuptim të thelluar të

nevojave në terren, çka ndihmon në ofrimin efektiv të shërbimeve dhe mbështetjes në mjedise të bazuara në komunitet.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

#### **Psikolog**

- Kryerja e vlerësimeve fillestare për të identifikuar nevojat emocionale, psikologjike dhe sociale të individëve dhe familjeve, duke përfshirë identifikimin e traumave dhe çështjeve të shëndetit mendor.
- Ofrimi i këshillimeve dhe terapisë psikologjike për individë dhe grupe familjare, me qëllim adresimin e stresit, ankthit, depresionit dhe çështjeve të tjera të shëndetit mendor që mund të jenë të pranishme për shkak të zhvendosjes dhe traumave të përjetuara.
- Hartimi dhe zbatimi i planeve të personalizuar të kujdesit për çdo anëtar të familjes, duke përfshirë strategjitë për përballimin e sfidave dhe përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme.
- Ofrimi i udhëzimeve dhe mbështetjes për procesin e integritit në komunitetin e ri, duke ndihmuar familjet të përshtaten me kulturën dhe normat lokale, dhe të ndërtojnë rrjete mbështetëse.
- Bashkëpunimi me menaxherët e rasteve, mësuesit, punonjësit socialë dhe partnerët e tjerë për të siguruar një qasje të integruar dhe të koordinuar në mbështetjen e familjeve afgane.
- Organizimi dhe drejtimi i grupeve të mbështetjes për të ofruar një hapësirë të sigurt ku individët mund të ndajnë përvojat e tyre dhe të marrin mbështetje nga të tjerët që po përballen me sfida të ngjashme.
- Ofrimi i sesioneve edukative dhe trajnimeve për familjet në lidhje me strategjitë e përballimit të stresit, kujdesin për shëndetin mendor, dhe teknikat për ndërtimin e reziliencës.
- Monitorimi i progresit të përfituesve dhe përshtatja e ndërhyrjeve terapeutike sipas nevojës, për të siguruar që të arrihen rezultatet e dëshiruara.
- Mbajtja e dokumentacionit të detajuar dhe raportimi i rregullt mbi ecurinë dhe rezultatet e ndërhyrjeve psikologjike, duke siguruar konfidencialitetin dhe përputhshmërinë me standardet profesionale.
- Ofrimi i mbështetjes emergjente dhe ndërhyrjes në rast të krizave psikologjike, duke përfshirë ndihmën për individët që mund të përjetojnë episode të rënda të stresit apo traumës.
- Zotëron aftësi shumë të mira komunikimi dhe nivel të lartë të të kuptuarit të çështjeve ndërkulturore.
- Demonstron ndjeshmëri të lartë ndaj çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve.

#### **Kualifikime dhe eksperiencia e punës:**

- Diplomë universitare në psikologji.
- Përvojë e mëparshme (të paktën 3-5 vjet) në ofrimin e shërbimeve psikologjike për individë dhe familje, me përparësi për ata që kanë punuar me grupe të zhvendosura, refugjatë, ose komunitete të prekura nga trauma dhe konflikte.
- Aftësi të forta për të punuar me individë nga kultura dhe sfondet e ndryshme, duke përfshirë një mirëkuptim të ndjeshëm të traditave dhe vlerave kulturore afgane.
- Aftësi për të komunikuar qartë dhe me ndjeshmëri, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për përfituesit. Aftësia për të punuar në mënyrë efektive si pjesë e një ekipi shumëdisiplinor.
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve;
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren dhe për të punuar me kategoritë vulnerabël;
- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e NISMA ARIS, politikat e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze;
- Aftësi shumë të mira në përdorimin e paketës MS Office

## Psikoterapist

- Ofrimi i seancave të rregullta terapeutike për individët dhe familjet, duke adresuar çështje të shëndetit mendor të lidhura me traumën, stresin post-traumatik, ankthin, depresionin dhe sfida të tjera emocionale që mund të kenë lindur nga zhvendosja dhe përvojat e tyre të mëparshme.
- Hartimi dhe zbatimi i planeve të personalizuara të trajtimit për çdo individ dhe familje, bazuar në nevojat specifike dhe historinë e tyre psikologjike, duke përdorur qasje terapeutike të përshtatshme si CBT (Terapia Kognitive Biheviore), EMDR (Desensitizimi dhe Përpunimi përmes Lëvizjeve të Syve), ose qasje të tjera të provuara.
- Sigurimi që seancat terapeutike të zhvillohen në një mjedis të sigurt, konfidencial dhe mbështetës, duke ndihmuar klientët të ndihen të kuptuar dhe të respektohen gjatë gjithë procesit të terapisë.
- Ndihma për familjet afgane në procesin e tyre të adaptimit dhe integritit në komunitetin e ri, duke adresuar sfidat që lidhen me ndryshimet kulturore, humbjen e identitetit, dhe ndjenjat e izolimit ose alienimit.
- Punimi ngushtë me menaxherët e rasteve, psikologët, punonjësit socialë dhe partnerët e tjerë për të siguruar një qasje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse në trajtimin dhe mbështetjen e familjeve afgane.
- Organizimi dhe drejtimi i seancave të terapisë në grup, të cilat ofrojnë një hapësirë për individët dhe familjet të ndajnë përvojat e tyre, të mbështesin njëri-tjetrin dhe të punojnë së bashku për të kapërcyer sfidat e përbashkëta.
- Monitorimi i vazhdueshëm i progresit të klientëve dhe përshtatja e qasjeve terapeutike bazuar në reagimet dhe nevojat e tyre të ndryshme gjatë kohës së trajtimit.
- Ofrimi i mbështetjes dhe ndërhyrjes emergjente në rast të krizave psikologjike, si episode të rënda të ankthit, depresionit, ose stresit post-traumatik, për të parandaluar përkeqësimin e gjendjes së klientëve.
- Mbatja e dokumentacionit të detajuar dhe raportimi i progresit terapeutik për çdo klient, duke siguruar që të dhënat të jenë të plota, të sakta dhe në përputhje me standardet etike dhe profesionale.
- Angazhimi në supervizion profesional dhe trajnim të vazhdueshëm për të siguruar zhvillimin e aftësive dhe qasjeve terapeutike, dhe për të mbajtur përditësimin me praktikat më të mira në fushën e psikoterapisë.

## Kualifikime dhe eksperiencia e punës:

- Diplomë universitare në psikologji.
- Përvojë e mëparshme (të paktën 3-5 vjet) në ofrimin e shërbimeve psikologjike për individë dhe familje, me përparësi për ata që kanë punuar me grupe të zhvendosura, refugjatë, ose komunitete të prekura nga trauma dhe konflikte.
- Njohuri të thelluara mbi shëndetin mendor, psikologjinë e traumës, dhe ndërhyrjet terapeutike për të ndihmuar individët dhe familjet që kanë përjetuar zhvendosje, stres post-traumatik dhe sfida të tjera të ngjashme.
- Aftësi të forta për të punuar me individë nga kultura dhe sfondet e ndryshme, duke përfshirë një mirëkuptim të ndjeshëm të traditave dhe vlerave kulturore afgane.
- Aftësi për të komunikuar qartë dhe me ndjeshmëri, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për përfituesit. Aftësia për të punuar në mënyrë efektive si pjesë e një ekipi shumëdisiplinor.
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me çështje të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren dhe për të punuar me kategoritë vulnerabel;
- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e NISMA ARSIS, politikat e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri.

- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze.
- Aftësi shumë të mira në përdorimin e paketës MS Office.

### **Punonjës social (menaxher rastesh)**

- Kryerja e vlerësimeve fillestare të detajuara për secilën familje afgane për të identifikuar nevojat e tyre specifike, përfshirë nevojat për strehim, ushqim, arsim, kujdes shëndetësor, mbështetje psikologjike dhe sociale.
- Zhvillimi i planeve të kujdesit të personalizuar për secilin rast, duke përcaktuar shërbimet dhe mbështetjen e nevojshme për të siguruar një integrim të suksesshëm në shoqëri dhe komunitet.
- Bashkëpunimi i ngushtë me psikoterapistët, psikologët, punonjësit socialë, mësuesit, dhe partnerët e tjerë për të siguruar një qasje të bashkërenduar dhe gjithëpërfshirëse për trajtimin e nevojave të përfituesve.
- Ndhimja për familjet afgane në aksesimin e shërbimeve të nevojshme, duke përfshirë regjistrimin në shkollë, sigurimin e kujdesit shëndetësor, ndihmën juridike, dhe shërbimet sociale.
- Ndhimja për përfituesit në procesin e tyre të integritit në komunitetin lokal, duke organizuar aktivitete sociale dhe edukative që promovojnë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën komunitare.
- Monitorimi i vazhdueshëm i progresit të secilës familje dhe përshtatja e planeve të kujdesit bazuar në ndryshimet e situatave dhe nevojave të tyre.
- Sigurimi që të drejtat e përfituesve të respektohen dhe mbrohen në të gjitha ndërhyrjet, duke avokuar për përfituesit në raste ku të drejtat e tyre mund të jenë të rrezikuara.
- Mbajtja e dokumentacionit të detajuar për secilin rast, duke përfshirë vlerësimet, planet e kujdesit, raportet e progresit dhe çdo ndërhyrje tjetër të rëndësishme. Përgatitja e raporteve periodike për supervisorët dhe donatorët për të siguruar transparencë dhe përmbushjen e objektivave të projektit.
- Menaxhimi i rasteve urgjente ose situatave të krizave duke ofruar mbështetje të menjëhershme dhe duke koordinuar me shërbimet përkatëse për të siguruar zgjidhjen e shpejtë dhe të përshtatshme të problemeve.
- Ofrimi i trajnimeve dhe edukimit për familjet afgane mbi të drejtat e tyre, mundësitë e arsimimit, kujdesin për shëndetin, dhe aftësitë për jetën e përditshme në Shqipëri.
- Bashkëpunimi me institucionet lokale dhe qendrore për të siguruar që familjet afgane të kenë akses të plotë në të gjitha shërbimet publike dhe të përfshihen në programet kombëtare dhe lokale për integrim dhe mbështetje.

### **Kualifikime dhe eksperiencia e punës:**

- Diplomë universitare në një fushë të lidhur me shkencat sociale, si punë sociale, psikologji, sociologji, ose menaxhim i shërbimeve sociale.
- Të paktën 3-5 vjet përvojë pune në menaxhimin e rasteve, veçanërisht me komunitete të zhvendosura, refugjatë ose grupe të tjera vulnerabël.
- Aftësi të shkëlqyera për të menaxhuar kohën, për të organizuar detyra të shumta dhe për të përmbushur afatet në një mjedis të dinamik dhe të ndryshueshëm.
- Aftësi të forta për të punuar me individë nga kultura dhe sfondet e ndryshme, duke përfshirë një mirëkuptim të ndjeshëm të traditave dhe vlerave kulturore afgane.
- Aftësi për të komunikuar qartë dhe me ndjeshmëri, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për përfituesit. Aftësia për të punuar në mënyrë efektive si pjesë e një ekipi shumëdisiplinor.
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren dhe për të punuar me kategoritë vulnerabël;

- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e NISMA ARSIS, politikat e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze.
- Aftësi shumë të mira në përdorimin e paketës MS Office.

### Mësues

- Hartimi dhe zbatimi i planeve mësimore të përshtatura për të përmbushur nevojat edukative të fëmijëve afganë
- Ofrimi i mësimave në gjuhën shqipe dhe anglisht për të ndihmuar fëmijët të përvetësojnë gjuhën dhe të ndihen më të përfshirë në komunitetin lokal.
- Ndihma për fëmijët afganë që të integrohen në shkollat lokale shqiptare, duke siguruar që ata të ndihen të mbështetur dhe të përfshirë në procesin e mësimin.
- Vlerësimi i nevojave të veçanta të çdo fëmije dhe sigurimi që ata të marrin mbështetjen e duhur, duke përfshirë ndihmën shtesë ose materiale edukative të personalizuar.
- Përdorimi i metodave edukative që njohin dhe respektojnë diversitetin kulturor, për të ndihmuar fëmijët të ndihen të mirëpritur dhe të vlerësuar.
- Ndjekja e përparimit të çdo fëmije dhe përshtatja e planeve mësimore për të siguruar që të gjitha nevojat e tyre arsimore janë duke u përmbushur.
- Mbajtja e dokumentacionit të detajuar të progresit të nxënësve dhe përgatitja e raporteve për menaxhmentin e projektit dhe prindërit.

### Kualifikime dhe eksperiencia e punës:

- Diplomë universitare në arsim ose një fushë të ngjashme.
- Të paktën 2 vjet përvojë në mësimdhënie, preferohet përvoja me fëmijët refugjatë, fëmijët nga mjedise të vështira, ose fëmijët që kanë nevojë për mbështetje të veçantë arsimore.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe angleze.
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren dhe për të punuar me kategoritë vulnerabël.
- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e NISMA ARSIS, politikat e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri.

### Animator Social

- Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve që promovojnë përfshirjen sociale dhe kulturore, si ngjarje kulturore, aktivitete sportive, dhe grupe të diskutimeve, për të ndihmuar fëmijët dhe familjet afgane të integrohen në komunitet.
- Ndihma për individët dhe familjet që të krijojnë lidhje dhe të ndihen të përfshirë në jetën e komunitetit lokal, duke organizuar mundësi për të ndarë dhe ndihmuar me aktivitete dhe shërbime lokale.
- Ndjekja e aktiviteteve dhe mbështetjes që ofrohen, duke mbajtur dokumentacion të detajuar dhe përgatitur raporte.
- Nxitja e respektit dhe ndjeshmërisë ndaj kulturave dhe praktikave të ndryshme për të ndihmuar në ndërtimin e një atmosfere të pranueshme dhe të respektueshme për të gjithë.
- Ofrimi i mundësive për individët dhe familjet për të kontribuar dhe përfshirë në vendimmarrjen dhe aktivitetet që ndikojnë në jetën e tyre dhe të komunitetit.

### Kualifikime dhe eksperiencia e punës:

- Diplomë universitare në shkencat sociale, edukim, psikologji, ose një fushë të ngjashme
- Të paktën 1-2 vjet përvojë në animacion social, menaxhim të aktiviteteve, ose punë sociale
- Aftësi për të kuptuar dhe respektuar diversitetin kulturor, dhe për të krijuar një ambient që promovon përfshirjen dhe mirëkuptimin ndërkulturor.

- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe angleze.
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren dhe për të punuar me kategoritë vulnerabël.
- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e NISMA ARIS, politikat e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri.

### Jurist

- Ofrimi i këshillave dhe konsultave ligjore për individët dhe familjet afgane në lidhje me të drejtat e tyre ligjore dhe proceset e integritimit në Shqipëri.
- Përfaqësimi i klientëve në procedura ligjore, duke përfshirë përfaqësimin në gjykata, në procedura administrative, dhe në takime me institucionet qeveritare.
- Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i dokumenteve ligjore, përfshirë aplikimet për leje qëndrimi, kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare, dhe dokumentet e tjera të nevojshme për integrim dhe mbrojtje ligjore.
- Informimi dhe këshillimi mbi politikat dhe rregulloret që ndikojnë në statusin dhe integrimin e individëve dhe familjeve afgane, duke siguruar që ata të jenë të informuar mbi ndryshimet ligjore dhe procedurat.
- Ndihma në mbledhjen dhe organizimin e dokumenteve të nevojshme për aplikime ligjore dhe administrativë.
- Ndihma në zgjidhjen e konflikteve ligjore që mund të lindin, përfshirë ndihmën në arritjen e marrëveshjeve dhe negociatave.
- Ndjekja e përparimit të rasteve dhe sigurimi që të gjitha hapat ligjorë janë në përputhje me procedurat dhe afatet e kërkuara.
- Mbajtja e dokumentacionit të detajuar të rasteve dhe përgatitja e raporteve për menaxhmentin dhe partnerët e projektit.
- Bashkëpunimi me organizata dhe institucione të tjera që ofrojnë shërbime për fëmijët dhe familjet afgane për të siguruar një mbështetje të integruar dhe efektive.

### Kualifikime dhe eksperiencia e punës:

- Diplomë universitare në Drejtësi.
- Të paktën 2-3 vjet përvojë në praktikën ligjore, preferohet përvoja në fushën e ligjit për refugjatët, të drejtave të njeriut, ose çështjeve të imigracionit.
- Njohuri të thella mbi ligjin ndërkombëtar për refugjatët, ligjin e imigracionit shqiptar dhe ndërkombëtar, dhe procedurat e integritimit.
- Aftësi për të identifikuar dhe zgjidhur çështjet ligjore dhe për të menaxhuar raste komplekse me ndjeshmëri dhe profesionalizëm.
- Aftësi për të punuar efektivisht në një ekip që përfshin profesionistë nga fusha të ndryshme dhe për të kontribuar në një qasje të integruar për mbështetje dhe ndihmë.
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren dhe për të punuar me kategoritë vulnerabël.
- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e NISMA ARIS, politikat e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri.

**Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve:** Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

**Koha e mundshme e fillimit të punës është 02 shtator 2024.**

**Procedura e Aplikimit:**

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dërgojnë me email:

- 1- Shprehje interesi;
- 2- Curriculum Vitae (evidenca të punëve të mëparshme të ngjashme);
- 3- 2 Referenca

Gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet në adresën e emailit: [info@nisma-aris.org](mailto:info@nisma-aris.org) deri në datën **27 Gusht 2024**, mesnatë, me subjekt: *Aplikimi për - Pozicioni e zgjedhur*

**Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazën e intervistimit do të kontaktohen.**